



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:136904

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05638465

KPPP.nr.381/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Artmotion” SH.P.K., me NUI:810200866, me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Pejës” Zona Industriale, kundër debitorit “Eset Dërguti” B.I., me NUI:810037574, me seli në Fushë Kosovë, rruga “Lidhja e Pejës” H.10 nr.6, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.265/22 të datës 12.05.2022, të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Eset Dërguti” B.I., ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.265/22 i datës 12.05.2022, i Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.265/22 të datës 12.05.2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr.FDP18-08-03243 të datës 01.08.2018, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të përmbartjes së obligimeve nga faturat më sipër, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 185.00 €, me kamatën prej 8%, nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri me pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë, me bartjen e mjeteve financiare nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë e veçantë bankare të kreditorit, me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit dhe pagesën e borxhit nga shitja e këtyre sendeve.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se fatura në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbartimore nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, e njëjta nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, nuk është e nënshkruar as e vulosur. Tutje ka shtuar se fatura objekt i kësaj procedure përmbartimore nuk i plotëson kushtet sipas nenit 29 të LPP-së. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta anuloj.

Kreditori në përgjigje në prapësim, e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit duke theksuar se fatura i ka të gjitha elementet e dokumentit të besueshëm, si dhe ka tipare të përmbartueshmërisë sipas nenit 29 të LPP-së. Tutje ka shtuar se fatura debitorit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt përmes email adresës me datë 23.04.2022, me vërejtje për mos përmbushjen e të njëjtës, andaj vetëm dorëzimi i faturës përmes postes elektronike, nënkupton pranimin e të njëjtës edhe pa qenë e nënshkruar ose e vulosur. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr.FDP18-08-03243 e datës 01.08.2018, në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3 të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti i besueshme - Fatura Nr. FDP18-08-03243 e datës 01.08.2018, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbaerim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e as vulën e debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori.

Duke qenë se debitori nuk ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartcekur, si e tillë nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbaerueshmërisë, përderisa njëra palë procedurale - debitori nuk ka pranuar një detyrim që rrjedh nga fatura.

Gjykata vlerësoi pretendimin e kreditorit se fatura në rastin konkret i është dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit përmes email adresës, duke bashkëngjitur si dëshmi email-in e datës 23.04.2022, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar, për faktin se në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi mbi konfirmim nga debitori se i njëjti e ka pranuar faturën përmes email adresës.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet e besueshme, mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbaerim, e mbi bazën e të cilave përmbaeruesi privat ka lejuar përmbaerimin, nuk kanë tipare të përmbaerueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaeruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaerimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.381/24, datë 30.04.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.